



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 297/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-10203-02-22-2019, me objekt Loti I “*Blerje dokumentacioni për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*”, me fond limit 4.853.449 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.”

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

“Kristalina - KH” sh.p.k.
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

“Albdesign PSP” sh.p.k.
Rruga “Çerçiz Topulli”, Nr.17, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.02.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-10203-02-22-2019, me objekt Loti I “*Blerje dokumentacioni për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*”, me fond limit 4.853.449 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 20.03.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 04.04.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Inpress” sh.p.k.	1,877.9 lekë, kualifikuar
2. “Kristalina KH” sh.p.k.	2,007 lekë, kualifikuar
3. “Albdesign PSP” sh.p.k.	2,313.5 lekë, kualifikuar
4. “Adel Co” sh.p.k.	2,395.4 lekë, kualifikuar
5. “Dynamix” sh.p.k.	2,438.5 lekë, kualifikuar
6. “Shtëpi botuese shtypshkronja Morava” sh.p.k.	2,445.3 lekë, kualifikuar
7. “Classic Print” sh.p.k.	2,483 lekë, kualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “Kristalina KH” sh.p.k. në datën 11.04.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon:

[...] Nga analizimi i situates, KVO ka kualifikuar per Lotin I dhe Lotin 2 operatorin ekonomik Inpress shpk. Shoqeria jone, Kristalina KH, e cila operon prej vitesh ne tregun e shtypshkrimeve, nga njohurite qe kemi na rezulton se, ky Operator Ekonomik, qe keni shpallur fitues ka mangesi te medha ne dokumentacionin e paraqitur ne SPE per keto dy procedura, konkretisht si me poshte:

-Operatori ekonomik pjesemarrës per Lotin I dhe Lotin 2, kriteret e vecanta, duhet te jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare ISO 9001 (te vlefshme) te sistemit te menaxhimit te cilesise Qellimi i certifikimit te kompanise duhet te jete sipas objektit qe do te prokurohet. Nga te dhenat tona, rezulton se ky operator nuk disponon ISO-n perkatese te lidhur me objektin e prokurimi.

-Operatori ekonomik pjesemarrës per Lotin 1 dhe Lotin 2, kriteret e vecanta, duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fondit limit te secilit

Lot sidomos ne Lotin e 1. Duke qene i shpallur fitues ne te dyja lotet ku operator ekonomik nuk ploteson kriteret e e kualifikimit qe te kete eksperience jo me pak se 40 % per secilin lot vecmas. Duke ditur specifiken e ketij tenderi dhe duke patur parasysh faktin qe eshte nje tender me rendesi kombetare mendojme se kjo kompani nuk mundet ta realizoje kete tender. Deftesat dhe rregjistrat kerkojne qe te realizohen ne kohe rekord dhe me nje cilesi te larte pasi sic e theksova edhe me lart kane nje rendesi te vecante kombetare. Nje kompani me eksperience te limituar ose pa experience identike e ka te pamundur ta perballoje dhe ta realizoje me sukses dhe si pasoje do kete vonesa ne realizimin e kontrates dhe cilesi te dobet. Per kete gje jemi te bindur pasi kemi eksperience te meparshme me kete tender. Deftesat jane punim me 4C dhe Inpress shpk nuk e ka vertetuar se ka eksperience te ngjashme ose identike cka e ben te pamundur qe ajo vete ta realizoje nje pune te tille me cilesi dhe korrektesi ne ditet e perfundimit te shkolles gje e cila mund te behet pengese pe nxenesit te cilet aplikojne per te studiuar jashte vendit ose per studentet te cilet duan te aplikojne per studime universitare Brenda vendit. Rregjistrat e shkollave dhe Amzat jane punime te vecanta, speciale dhe mjaft specifike te cilat mund te realizohen nga nje kompani me cikël te mbyllur prodhimi, dhe me nje staf mbi 20 persona dhe te gjithë me experience disa vjecare dhe me makineri qe ofrojne rendiment per punimet special. Kompania ne fjale nuk verteton se ka kapacitet te mjaftueshem te asnje lloji per realizimin e ketyre punimeve dhe me specifikisht te Lotit I i cili ka rendesi kombetare dhe ndjeshmeri kombetare qe lidhet me realizimin ne kohe dhe me cilesi. Ne nuk kemi informacion se cfare profesionesh ka te deklaruar kjo kompani si te punesuar prane saj. Nuk e dime nese ka makiniste (disa) staf liberlidhje (disa), makine per punime speciale rregjistra, libra etj, makine qepje me pe per qepjen e fashikujve te rregjistrave dhe Amzave. Keto qe po citojme jane te detyrueshme per mendimin tone pasi pervec periudhes 1 nje vjecare te perdorimit te perditshem te tyre ato gjithashtu ruhen per nje periudhe 10 vjecare cka e ben absolutisht te nevojshme cilesine e tyre dhe eksperiencen ne mos identike te pakten teper te ngjashme. Ne dijenine tone Inpress shpk nuk ka vertetuar se ka realizuar me perpara artikuj qe kane specifikimet e meposhteme (te mara si shembulj).

28. Certifikate Matura Shteterore (per gjimnazin, shkollat e mesme te arsimit te orientuar, me kohe te pjesshme etj)

Numri i fleteve per cope: 1(nje); shtypur ne nje ane,
 Numri i ngjyrave: 4(kater)
 Formati i prere: 210 mm x 297 mm
 Lloji i letrës: matt,150 g/m2,
 Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur, i pafaqosur dhe i padizajnuar
 Ambalazhim: pako te etiketuara me 100 cope, mbeshtjelle me leter.

29. Fletelavderimi

Numri i fleteve per cope: 1(nje), shtypur ne nje ane,
 Numri i ngjyrave: 4 (kater)
 Formati 1 prere: 200 mm x 300 mm
 Lloji i letrës: "matt,170gm2;
 Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur, i pafaqosur dhe i padizajnuar
 Ambalazhimi: pako te etiketuara me 100 cope, mbeshtjelle me leter

41. Register per klasen e dhjete te gjimnazit dhe shkollave te arsimit te orientuar)

Blloku:

Numri i faqeve: 218

Numri i ngjyrave: 1
 Formati i prere: 24 cm x 34 cm.
 Lloji i letres: offsejt, 80 g/m²
 Kapaku: karton me trashes 2 mm; veshur se jashtmi me leter te dekoruar 100g/m²
 Forma e lidhjes fashikujt te qepur me pen
 bashkimi i bllokut me kapakun
 me lidhje speciale(me garze);
 astar me leter 130 g/m²,
 Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur dhe i pafaqosur
 Ambalazhimi: pako te etiketuara me 5 cope, mbeshtjelle me leter.

44. Amza per shkollat 9-vjecare

Blloku:
 Numri i faqeve: 208
 Numri i ngjyrave 1
 Formati i prere: 49 cm x 34 cm
 Lloji i letres: offsejt, 80 g/m²
 Kapaku: karton me trashesi 2 mm; veshur se jashtmi me leter te dekoruar 100g/m²
 Forma e lidhjes: fashikujt te qepur me penj
 bashkimi i bllokut me kapakun
 me lidhje special (me garze)
 astar me leter 130 g/m²

Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur dhe i pafaqosur
 Ambalazhimi: pako te etiketuara me 2 cope, mbeshtjelle me leter
 Keto lloj produktesh rregjistrat dhe Amzat duhet te jene ditën e pare te fillimit te shkolles te shperndara neper shkolla per shkak se fusha e arsimit eshte shume i ndjeshem. Kjo kompani nuk ka eksperiencia dhe kontrata te vecanta per keto lloj punimesh.
 Operatori ekonomik pjesemarres per Lotin I dhe Lotin 2, kriteret e vecanta, per te vertetuar qe ka kapacitetet teknik per te ekzekutuar kontraten duhet te disponoje pajisjet perkatese sipas loteve. Referuar sugjerimeve te APP, ne procedurat e prokurimit me lote, kriteret e vecanta te kualifikimit duhet te plotesohen vecmas per cdo procedure prokurimi Ne kete rast, operatori ekonomik Inpress Sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion proves se disponon mjete vecmas per realizimin e ketyre dy loteve.

II.4.1. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 17.04.2019, me anë të shkresës nr.657/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

“[...] Lidhur me pretendimet ndaj ofertuesit "Inpress" shpk.

1. Ankimuesi “Kristalina Kh” shpk ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit “Inpress” shpk me pretendimin si vijon: “...se ofertuesi pjesemarres per Lotin I dhe Lotin II, kriteret e vecanta, duhet te jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare ISO 9001 (e vlefshme) te sistemit te menaxhimit te cilesise. Qellimi i certifikimit te kompanise duhet te jete sipas objektit qe do te prokurohet dhe per kete arsye, ankimuesi pretendon se ofertuesi "Inpress" SHPK nuk disponon ISO-n perkatese te lidhur me objektin e prokurimit”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit të ofertave lidhur me procedurën e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Inpress" SHPK për këtë procedurë në SPE, konstatoi se: Ofertuesi "Inpress" SHPK ka dorezuar në sistemin e prokurimit elektronik si pjesë të ofertës së tij për Lotin I dhe Lotin II, certifikatën ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësive, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe me qëllim të certifikimit të kompanie sipas objektit që kerkohet të prokurohet.

Organi i vleresimit të konformitetit që ka leshuar certifikatën ISO 9001 për ofertuesin "Inpress" SHPK rezulton të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, e për më tepër kjo certifikatë mban logon "DA". Verifikimet janë bërë në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018.

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ankimesit "Kristalina KH" SHPK nuk pranohet.

2. Ankimesi "Kristalina Kh" shpk ka ankimuar kualifikimin e ofertës së ofertuesit "Inpress" shpk me pretendimin si vijon: "....se operatori pjesëmarrës për Lotin I dhe Lotin I, kriteret e vecanta, duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të bërë gjatë 3 tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të secilit lot sidomos në Lotin e I. Ankimesi pretendon se ky operator ekonomik i shpallur fitues për të dyja Lotet, nuk plotëson kriteret e kualifikimit që të këtë eksperiencë jo më pak se 40 %o për secilin Lot vecmas, dhe gjithashtu pretendohet se duke ditur rëndësinë kombëtare të këtij tenderi, operatori ekonomik fitues "Inpress" SHPK nuk mund të realizojë këtë tender, pasi nuk ka eksperiencën e duhur për të përmbushur këtë kontratë. Gjithashtu ankimesi pretendon se ofertuesi pjesëmarrës për Lotin I dhe Lotin I, kriteret e vecanta, për të vërtetuar që ka kapacitetet teknik për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë pajisjet perkatese dhe një staf teknik mbi 20 persona (sipas disa profesioneve të caktuara) sipas loteve. Ai parashtron se referuar sugjerimeve të APP, në procedurat e prokurimit me lote, kriteret e vecanta të kualifikimit duhet të plotësohen vecmas për çdo procedurë prokurimi. Në këtë rast, operatori ekonomik "Inpress" shpk nuk ka paraqitur dokumentacionin për të disponon mjete vecmas për realizimin e ketyre dy Loteve." Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit të ofertave lidhur me procedurën e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Inpress" SHPK për këtë procedurë në SPE, konstatoi se Ofertuesi "Inpress" SHPK ka dorezuar në sistemin e prokurimit elektronik si pjesë të ofertës së tij, për Lotin I dhe Lotin II, fatura tatimore shitje me objekt të ngjashëm me objektin që kerkohet të prokurohet, të tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës dhe në një vlerë më të madhe se 40% e fondit limit, duke plotësuar kështu kriterin e përcaktuar në piken I të seksionit 23 "Kapaciteti teknik" të kriterëve të vecanta të kualifikimit në dokumentat e tenderit, për secilin Lot. Ofertuesi "Inpress SHPK ka dorezuar në sistemin e prokurimit elektronik si pjesë të ofertës së tij, për Lotin I dhe Lotin II, edhe fatura tatimore shitje, vendim për shpalljen e fituesit të ankandit, mandat arketimi, formular transferi bankarë si dhe kopje të certifikuar të bilancit të vitit 2017, të nënshkruar dhe vëlosur nga institucioni perkates tatimor, të shoqëruar me shkresën e autoritetit perkates tatimor që konfirmon paraqitjen e tij. Në zërin "Aktivet afatgjatë materiale" të pasqyrave financiare, rezultojnë të deklaruara dhe konfirmuara nga tatimet, në pronesi të "Inpress" shpk, ndër

të tjera edhe pajisjet: 1) makine shtypi me format 50 cm X 70 cm; 2) makine qepëse; 3) makine telefoni. Nga teresia e dokumentacionit të dorezuar nga ofertuesi "Inpress SHPK" komisioni i

vleresimit te ofertave ka arritur te krijoj bindjen, bazuar edhe ne piken 4 te nenit 53 te LPP-se, se ky ofertues disponon pajisjet minimale te kerkuara ne DST dhe te domosdoshme per realizimin e kesaj procedure.

Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit, se ofertuesit pjesemarres per Lotin I dhe Lotin II, per te vertetuar qe kane kapacitetet teknik per te ekzekutuar kontraten, duhet te disponojne edhe nje staf teknik mbi 20 persona (sipas disa profesioneve te caktuara) sipas loteve, ju sjellim ne vemendje se ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te Dokumentave te Tenderit, nuk eshte percaktuar ndonje kerkese apo kriter per staf teknik ose numer punonjesish, e per rrjedhim edhe vleresimi i ofertave nuk mund te behet per kriteret e cilat nuk jane percaktuar ne dokumentat e tenderit. Sjellim ne vemendje te ankimuesit edhe se gjate afatit 7 ditor nga data e publikimit te dokumentave te tenderit, nuk eshte paraqitur ndonje ankese ne lidhje me kriteret e dokumentave te tenderit, per asnje nga 4 lotet e procedures, bazuar ne Ligjin nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", ndryshuar, neni 63, pika 1.1 [...].

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ankimuesit "Kristalina KH" sh.p.k. nuk pranohet.

II.4.2. Në datën 26.04.2019 operatori ekonomik "Kristalina KH" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik ku kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik "Inpress" sh.p.k. Konkretisht, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme, por ka hequr dorë nga pretendimi në lidhje me certifikatat ISO. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon:

[...] Nga analizimi i situates, KVO ka kualifikuar per Lotin I operatorin ekonomik Inpress shpk. Shoqeria jone, Kristalina KH, e cila operon prej vitesh ne tregun e shtypshkrimeve, nga njohurite qe kemi na rezulton se, ky Operator Ekonomik, qe keni shpallur fitues ka mangesi te medha ne dokumentacionin e paraqitur ne SPE per keto dy procedura, konkretisht si me poshte:

-Operatori ekonomik pjesemarres per Lotin 1, kriteret e vecanta, duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fondit limit te secilit Lot sidomos ne Lotin e 1. Duke qene i shpallur fitues ne te dyja lotet ku operator ekonomik nuk ploteson kriteret e e kualifikimit qe te kete eksperience jo me pak se 40 % per secilin lot vecmas. Duke ditur specifiken e ketij tenderi dhe duke patur parasysh faktin qe eshte nje tender me rendesi kombetare mendojme se kjo kompani nuk mundet ta realizoje kete tender. Deftesat dhe rregjistrat kerkojne qe te realizohen ne kohe rekord dhe me nje cilesi te larte pasi sic e theksova edhe me lart kane nje rendesi te vecante kombetare. Nje kompani me eksperience te limituar ose pa experience identike e ka te pamundur ta perballoje dhe ta realizoje me sukses dhe si pasoje do kete vonesa ne realizimin e kontrates dhe cilesi te dobet. Per kete gje jemi te bindur pasi kemi eksperience te meparshme me kete tender. Deftesat jane punim me 4C dhe Inpress shpk nuk e ka vertetuar se ka eksperienca te ngjashme ose identike cka e ben te pamundur qe ajo vete ta realizoje nje pune te tille me cilesi dhe korrektesi ne ditet e perfundimit te shkolles gje e cila mund te behet pengese pe nxenesit te cilet aplikojne per te studiuar jashte vendit ose per studentet te cilet duan te aplikojne per studime universitare Brenda vendit. Rregjistrat e shkollave dhe Amzat jane punime te vecanta, speciale dhe mjaft specifike te cilat mund te realizohen nga nje kompani me cikël te mbyllur prodhimi, dhe me nje staf mbi 20 persona dhe te gjithë me experience disa vjecare dhe me makineri qe ofrojne rendiment per punimet special. Kompania ne fjale nuk verteton se ka kapacitet te mjaftueshem te asnje lloji per realizimin e ketyre punimeve dhe me specifikisht te Lotit I i cili ka

rendesi kombetare dhe ndjeshmeri kombetare qe lidhet me realizimin ne kohe dhe me cilesi. Ne nuk kemi informacion se cfare profesionesh ka te deklaruar kjo kompani si te punesuar prane saj. Nuk e dime nese ka makiniste (disa) staf liberlidhje (disa), makine per punime speciale rregjistra, libra etj, makine qepje me pe per qepjen e fashikujve te rregjistrave dhe Amzave. Keto qe po citojme jane te detyrueshme per mendimin tone pasi pervec periudhes 1 nje vjecare te perdorimit te perditshem te tyre ato gjithashtu ruhen per nje periudhe 10 vjecare cka e ben absolutisht te nevojshme cilesine e tyre dhe eksperiencen ne mos identike te pakten teper te ngjashme.

Ne dijenine tone Inpress shpk nuk ka vertetuar se ka realizuar me perpara artikuj qe kane specififikimet e meposhteme (te mara si shembuj).

28. Certificate Matura Shteterore (per gjimnazin, shkollat e mesme te arsimit te orientuar, me kohe te pjesshme etj)

Numri i fleteve per cope: 1(nje); shtypur ne nje ane,

Numri i ngjyrave: 4(kater)

Formati i prere: 210 mm x 297 mm

Lloji i letrave: matt,150 g/m²,

Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur, i pafaqosur dhe i padizajnuar

Ambalazhim: pako te etiketuara me 100 cope, mbeshtjelle me leter.

29. Fletelavderimi

Numri i fleteve per cope: 1(nje), shtypur ne nje ane,

Numri i ngjyrave: 4 (kater)

Formati i prere: 200 mm x 300 mm

Lloji i letrave: "matt,170g/m²;

Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur, i pafaqosur dhe i padizajnuar

Ambalazhimi: pako te etiketuara me 100 cope, mbeshtjelle me leter

41. Register per klasen e dhjete te gjimnazit dhe shkollave te arsimit te orientuar)

Blloku:

Numri i faqeve: 218

Numri i ngjyrave: 1

Formati i prere: 24 cm x 34 cm.

Lloji i letrave: offsejt, 80 g/m²

Kapaku: karton me trashes 2 mm; veshur se jashtmi me leter te dekoruar 100g/m²

Forma e lidhjes fashikujt te qepur me pen

bashkimi i bllokut me kapakun

me lidhje speciale(me garze);

astar me leter 130 g/m²,

Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur dhe i pafaqosur

Ambalazhimi: pako te etiketuara me 5 cope, mbeshtjelle me leter.

44. Amza per shkollat 9-vjecare

Blloku:

Numri i faqeve: 208

Numri i ngjyrave 1

Formati i prere: 49 cm x 34 cm

Lloji i letrave: offsejt, 80 g/m²

Kapaku: karton me trashesi 2 mm; veshur se jashtmi me leter te dekoruar 100g/m²

*Forma e lidhjes: fashikujt te qepur me penj
bashkimi i bllokut me kapakun
me lidhje special (me garze)
astar me leter 130 g/m2*

Forma e dorezimit per shtyp: model i paradhitur dhe i pafaqosur

Ambalazhimi: pako te etiketuara me 2 cope, mbeshtjelle me leter

Keto lloj produktesh rregjistrat dhe Amzat duhet te jene ditën e pare te fillimit te shkolles te shperndara neper shkolla per shkak se fusha e arsimit eshte shume i ndjeshem. Kjo kompani nuk ka eksperience dhe kontrata te vecanta per keto lloj punimesh.

II.5. Operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. në datën 10.04.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Inpress” sh.p.k. dhe “Kristalina KH” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon:

[...] Operatori ekonomik Inpress dhe Kristalina KH qe jane operatore te kualifikuar e te paret pra me oferte me te ulet se shoqeria jone, kane mangesi ne dokumentacion e per kete duhet te skualifikohen. Nga informacionet qe kemi si shoqeri qe operojme ne te njejtin treg dhe duke qene se njohim firmat qe tenderojne ne kete fushe shprehemi se keto firma nuk plotesojne kriteret e peraktuar ne dokumentat e tenderit.

-shoqeria Inpress ka mangesi sepse mendojme se nuk ka paraqitur Shtojcen 6 Deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme dhe nuk ka plotesuar ate edhe per amdinistratoret dhe stafin tjeter sipas percaktimeve ligjore ne fuqi te permiresuara ne fundmi.

-Certifikata ISO 9001 nuk eshte sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderit pasi shoqeria Inpress shpk nuk e ka te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizma kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

-bilancet e paraqitura te shoqerise Inpress shpk nuk jane te certifikuara prane autoriteteve tatimore sipas kerkeses se dST ne pike 2.2. pika 2 te DST shtojca 9.

-makinerite e paraqitura nga shoqeria Inpresa shpk nuk jane sipas specifikimeve te kerkuara ne DST dhe nuk kane dokumentacionin e duhur shoqerues pasi mungon dokumentacioni qe verteton disponimin per keto mjete.

-shoqeria Inpresa shpk nuk ka paraqitur dokumentin per te vertetuar se ka shyer te gjitha detyrimet ne lidhje me energjine elektrike sipas ekstraktit te QKR.

-shoqeria Kristalina KH ka mangesi ne dokumentacion pasi nuk ka paraqitur Shtojcen 6 Deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme dhe nuk ka plotesuar ate edhe per administratoret dhe stafin tjeter sipas percaktimeve ligjore ne fuqi te permiresuara se fundmi.

-Certifikata ISO 9001 nuk eshte sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderit pasi shoqeria Kristalina KH shpk nuk e ka te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

-makinerite e paraqitura nga shoqeria Kristalina KH shpk nuk jane sipas specifikimeve te kerkuara ne dst dhe nuk kane dokumentacionin e duhur shoqerues pasi mungon dokumentacioni qe verteton disponimin per keto mjete sipas te gjitha percaktimeve te kriterëve ne DST.

Si perfundim kerkojme qe autoriteti kontraktor ne mbeshtetje te parimeve te barazise mosdiskriminimit dhe transparences te skualifikoje shoqerite me siper si shoqeri me mangesi ne dokumentat e paraqitura ne SPE per kete procedure prokurimi.

II.5.1. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 17.04.2019, me anë të shkresës nr.643/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

“[...] Lidhur me pretendimet ndaj ofertuesit "Inpress" SHPK

1. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit "Inpress" SHPK me pretendimin si vijon: "ka mangesi se nuk ka paraqitur Shtojcen 6 Deklaraten mbi permbushjen e kriterere te pergjithshme dhe nuk ka plotesuar ate edhe per administratoret dhe stafin tjeter sipas percaktimeve ligjore ne fuqi te permiresuara se fundmi.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me proceduren e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Inpress" SHPK per kete procedure ne SPE konstatoi se:

Ofertuesi "Inpress" SHPK ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjese te ofertes se tij Shtojcen 6 "Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknik" dhe Shtojcen 8 "Deklarate mbi permbushjen e kriterereve te pergjithshme te plotesuar dhe nenshkruar ne perputhje me kerkesat e organit qendror bleres dhe legjislacionit ne fuqi. Me konkretisht ofertuesi "Inpress" SHPK ka deklaruar nepermjet Shtojces 8, se as operatori ekonomik dhe as personi/at ne cilesine e anetarit te organi administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit -ose ortakut, ose qe ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatori ekonomik (duke listuar emrat e tyre), nuk jane ose kane qene te denuar me vendim gjyqesor te formes se prere per asnje nga veprat penale, te percaktuara ne nenin 45/1 te LPP. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" SHPK nuk pranohet.

2. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit "Inpress" SHPK me pretendimin si vijon: "Certifikata ISO 9001 nuk eshte sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderit pasi shoqeria "Inpress" shpk nuk e ka te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise".

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me proceduren e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Inpress" SHPK per kete procedure ne SPE konstatoi se:

Ofertuesi "Inpress" shpk ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjesë të ofertës se tij, certifikaten ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures dhe me qellim te certifikimit te kompanise sipas objektit qe kerkohet te prokurohet. Organi i vleresimit te konformitetit qe ka leshuar certifikaten ISO 9001 per ofertuesin "Inpress shpk", rezulton te jete i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, e per me teper kjo certifikate mban logon "DA". Verifikimet jane bere ne zbatim te Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe DPA-sa ne fuqi nga data 20.03.2018. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" sh.p.k. nuk pranohet.

3. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit "Inpress" shpk me pretendimin si vijon: "...bilancet e paraqitura te shoqerise Inpress SHPK nuk jane te

certifikuara prame autoriteteve tatimore sipas kerkeses se DST ne piken 2.2 pika 2 te DST shtojca 9”.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me procedure e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Inpress" SHPK per kete procedure ne SPE konstatoi se Ofertuesi "Inpress" SHPK ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjese te ofertes se tij edhe kopje te certifikuara te bilanceve (pasqyrat financiare) te viteve 2015, 2016, 2017 te nenshkruara dhe vulosura nga institucioni perkates tatimor, si dhe te shoqeruara me shkresen e autoritetit perkates tatimor qe konfirmon paraqitjen e tyre. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" sh.p.k. nuk pranohet.

4. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit "Inpress" SHPK me pretendimin si vijon: "...makinerite e paraqitura nga shoqeria Impresa shpk nuk jane sipas specifikimeve te kerkuara ne DST dhe nuk kane dokumentacionin e duhur shoqerues pasi mungon dokumentacioni qe verteton disponimin per keto mjete”.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me procedure e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Inpress SHPK" per kete procedure ne SPE konstatoi se: Ofertuesi "Inpress SHPK" ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjese te ofertes se tij, edhe fature tatimore shitje, vendim per shpalljen e fituesit te ankandit, mandat arketimi, formular transferte bankare si dhe kopje te certifikuar te bilancit te vitit 2017 te nenshkruar dhe vulosur nga institucioni perkates tatimor, te shoqeruara me shkresen e autoritetit perkates tatimor qe konfirmon paraqitjen e tij. Ne zerin "Aktivet afatgjata materiale" te pasqyrave financiare rezultojne te deklaruar dhe konfirmuara nga tatimet, ne pronesi te "Inpress SHPK", nder te tjera edhe pajisjet: 1) makine shtypi me format 50 cm X 70 cm: 2) makine qepese: 3) makine telefoni. Nga teresia e dokumentacionit te dorezuar nga ofertuesi "Inpress SHPK" komisioni i vleresimit te ofertave ka arritur te krijojë bindjen, bazuar edhe ne piken 4 te nenit 53 te LPP-se se ky ofertues i disponon pajisjet minimale te kerkuara ne DST dhe te domosdoshme per realizimin e kesaj procedure. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" SHPK nuk pranohet.

5. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit "Inpress" SHPK me pretendimin si vijon: “nuk ka paraqitur dokumentin per te vertetuar se ka shyer te gjitha detyrimet ne lidhje me energjiine elektrik sipas ekstraktit te QKR.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me procedure e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Inpress" SHPK per kete procedure ne SPE konstatoi se: Ofertuesi "Inpress SHPK" ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjese te ofertes se tij, edhe Vertetim debie te leshuar nga Operatori i Shperndares se Energjise Elektrike, nepermjet te cilit vertetohet se ofertuesi "Inpress" SHPK i ka shyer detyrimet per faturat e energjise elektrike per kontraten/ kontratat ku rezulton perdorues. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" SHPK nuk pranohet.

II. Lidhur me pretendimet ndaj ofertuesit "Kristalina KH" SHPK

1. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit "Kristalina KH" SHPK me pretendimin si vijon: " shoqeria Kristalina KH ka mangesi ne dokumentacion pasi nuk ka paraqitur Shtojcen 6 Deklaraten mbi permbushjen e kriterere te pergjithshme dhe nuk ka

plotesuar ate edhe per administratoret dhe stafin tjeter sipas percaktimeve ligjore ne fuqi te permiresuara se fundmi."

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me proceduren e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi " Kristalina KH " SHPK per kete procedure ne SPE konstatoi se:

Ofertuesi " Kristalina KH " SHPK ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjese te ofertes se tij Shtojcen 6 "Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknik" dhe Shtojcen 8 "Deklarate mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme te plotesuar dhe nenshkruar ne perputhje me kerkesat e organit qendror bleses dhe legjislacionit ne fuqi. Me konkretisht ofertuesi " Kristalina KH " SHPK ka deklaruar nepermjet Shtojces 8, se as operatori ekonomik dhe as personi/at ne cilesine e anetarit te organi administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit - ose ortakut, ose qe ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatori ekonomik (duke listuar emrat e tyre), nuk jane ose kane qene te denuar me vendim gjyqesor te formes se prere per asnje nga veprat penale, te percaktuara ne nenin 45/1 te LPP. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" SHPK nuk pranohet.

2. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit " Kristalina KH " SHPK me pretendimin si vijon: "Certifikata ISO 9001 nuk eshte sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderit pasi shoqeria " Kristalina KH " shpk nuk e ka te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise".

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me proceduren e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi " Kristalina KH " SHPK per kete procedure ne SPE konstatoi se:

Ofertuesi " Kristalina KH" shpk ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjesë të ofertës se tij, certifikaten ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures dhe me qellim te certifikimit te kompanise sipas objektit qe kerkohet te prokurohet. Organi i vleresimit te konformitetit qe ka leshuar certifikaten ISO 9001 per ofertuesin "Kristalina KH shpk", rezulton te jete i akredituar nga organizma ndërkombetar i akreditimit. Verifikimet jane bere ne zbatim te Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe DPA-sa ne fuqi nga data 20.03.2018. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" sh.p.k. nuk pranohet.

3. Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit "Kristalina KH" SHPK me pretendimin si vijon: "...makinerite e paraqitura nga shoqeria Kristalina KH shpk nuk jane sipas specifikimeve te kerkuara ne DST dhe nuk kane dokumentacionin e duhur shoqerues pasi mungon dokumentacioni qe verteton disponimin per keto mjete".

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me procedure e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi "Kristalina KH" per kete procedure ne SPE konstatoi se: Ofertuesi "Kristalina KH" ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin sipas formës se kërkuar nepermjet te cilit arrihet te provohet disponimi I pajisjeve: 1) makine shtypi me format 50 cm X 70 cm: 2) makine qepese: 3) makine telefoni. Nga teresia e dokumentacionit te dorezuar nga ofertuesi " Kristalina KH " rezulton se ky ofertues i disponon pajisjet minimale te kerkuara ne DST dhe te domosdoshme per realizimin e kesaj procedure. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" SHPK nuk pranohet.

Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organi qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik ne perputhje me nenin 63 pika 6, te LPP.

II.5.2. Në datën 26.04.2019 operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 778/1 prot., datë 10.05.2019, protokolluar me tonën në datën 14.05.2019, me objekt “*Dërgim dokumentacioni për Lotin I, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dokumentacioni” për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. me arsyetimin se: “*shoqeria Kristalina KH ka mangesi ne dokumentacion pasi nuk ka paraqitur Shtojcen 6 Deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme dhe nuk ka plotësuar ate edhe per administratoret dhe stafin tjeter sipas percaktimeve ligjore ne fuqi te permiresuara se fundmi*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “*Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme*”, përcaktohet:

Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

• Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

• Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

• Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

• Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

• Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

III.1.2. Në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit, “Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit”, përcaktohet:

[...]

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k., për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme e plotësuar sipas shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

III.1.4. Në nenin 15 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes. “Përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit.

Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.”

III.1.5. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në shtojcën Nr. 8 të dokumentave të procedurës objekt shqyrtimi, është përcaktuar “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, shtojcë kjo e cila duhet të plotësohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në emër të operatorit ekonomik si dhe për personat e tjerë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Referuar dokumentave të tenderit, Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit, të cilat janë të detyrueshme dhe nuk duhet të ndryshohen në asnjë rast nga autoriteti kontraktor, përcaktohet se, këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, se operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. nuk ka paraqitur Shtojcën 8 Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe nuk e ka plotësuar atë edhe për administratorët dhe stafin tjetër sipas përcaktimeve ligjore ne fuqi, KPP, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, si dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. konstaton se ky i fundit, ka paraqitur “Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit. Gjithashtu, KPP nga verifikimi i këtij dokumentacioni si dhe Ekstraktit të Regjistrit Tregtar të shoqërisë “Kristalina – KH” sh.p.k. konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar këtë shtojcë në emër të operatorit ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. si dhe për administratorin dhe ortakun e vetëm të kësaj shoqërie Z. K.H.

Akoma më tej, në nenin 15 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se, përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.

Sa më sipër, operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. ka përmbushur më së miri kërkesat e autoritetit kontraktor duke plotësuar “Deklaratën mbi Përmbushjen e Kriterëve të Përgjithshme”, sipas shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. me arsyetimin se “[...]Certifikata ISO 9001 nuk eshte sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderit pasi shoqeria Kristalina KH shpk nuk e ka te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit për Lotin I, Shtojca 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.1. Kapaciteti ligjor, pika 1, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“1.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001 (të vlefshme) të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorëzoje certifikata ISO sipas zërave te punëve /mallrave /shërbimeve qe do të marrë përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.”

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k., rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Çertifikatë ISO 9001:2015, lëshuar nga Certi Ë Baltic SIA, me anë të të cilës vërtetohet se sistemi i menaxhimit i Kristalina – KH sh.p.k. është në përputhje me kërkesat e standartit ISO 9001:2015 për veprimtarinë e mëposhtme: Sigurimi i veprimtarive të topografisë dhe printimit të materialeve të reklamimit, botimit si dhe materialeve të tjera.

Certifikatë kjo e akredituar nga trupa akredituese LATTA – Letoni.

III.2.3. Operatori ekonomik ankimes pretendon: *Certifikata ISO 9001 nuk eshte sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderit pasi shoqeria Kristalina KH shpk nuk e ka te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.*

III.2.4. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes argumenton se: *Ankimuesi "Albdesign PSP" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertes se ofertuesit " Kristalina KH " SHPK me pretendimin si vijon: “Certifikata ISO 9001 nuk eshte sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderit pasi shoqeria " Kristalina KH " shpk nuk e ka te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise”.*

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga nga komisioni i vleresimit te ofertave lidhur me proceduren e vleresimit dhe dokumentat e dorezuara nga ofertuesi " Kristalina KH " SHPK per kete procedure ne SPE konstatoi se:

Ofertuesi " Kristalina KH" shpk ka dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik si pjesë të ofertës se tij, certifikaten ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures dhe me qellim te certifikimit te kompanise sipas objektit qe kerkohet te prokurohet. Organi i vleresimit te konformitetit qe ka leshuar certifikaten ISO 9001 per ofertuesin "Kristalina KH shpk", rezulton te jete i akredituar nga organizma ndërkombetar i akreditimit. Verifikimet jane

bere ne zbatim te Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe DPA-sa ne fuqi nga data 20.03.2018. Per arsyet e mesiperme, pretendimi i ankimuesit "Albdesign PSP" sh.p.k. nuk pranohet.

III.2.5. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar rekomandimi mbi hartimin e kërkesave të cilësisë i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, datë 20.03.2018 (data e protokollimit pranë APP), shoqëruar me Manualin teknik *"Mbi mënyrën e marrjes së informacionit për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë"*.

Në këtë rekomandim, është përcaktuar: *"Të gjitha certifikatat e cilësisë, të cilat vlerësohen të nevojshme të kërkojnë nga autoriteti kontraktor, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë"*.

Gjithashtu, në manualin teknik, përcaktohen mënyrat, se si merret informacioni për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë.

Në këtë manual janë të përcaktuara detajet në lidhje me organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, mënyrën se si mund të merret informacioni nëse një OVK është i akredituar apo jo nga DPA, mënyrën se si mund të merret informacion nëse certifikata apo raporti i lëshuar nga OVK e akredituar është aktualisht i vlefshëm, si mund të merret informacion nëse një OVK është akredituar nga organizma akreditues të huaj, mënyrën si mund të gjendet që një OVK është e akredituar nga një organizëm akreditues dhe cila është fusha e akreditimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, i cili sqaron se, ka kryer verifikimet përkatëse në lidhje me certifikatën e paraqitur nga operatori ekonomik "Kristalina – KH" sh.p.k., si edhe nga verifikimi i kryer, bazuar në këtë manual në faqet zyrtare të organeve që kanë lëshuar certifikatën ISO 9001:2015 në drejtim të shoqërisë "Kristalina - KH" sh.p.k. rezulton se, ky i fundit ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Ashtu siç edhe autoriteti kontraktor informon, konstatohet se shoqëria "Kristalina - KH" sh.p.k. është pajisur me certifikatën ISO 9001:2015 lëshuar nga Certi Ë Baltic SIA, me vulën përkatëse nga trupa akredituese LATTAQ. Nga verifikimi referuar edhe manualit teknik, sipas të cilit DPA njeh të barazvlefshëm certifikata akreditimi të lëshuara nga organet akredituese që kanë nënshkruar marrëveshje të njohjes reciproke, rezulton se LATTAQ në Letoni, ashtu si edhe DPA në Shqipëri, është e njohur nga EA. Nga verifikimi në faqen zyrtare të LATTAQ, rezulton se subjekti Certi Ë Baltic SIA që ka lëshuar certifikatën ISO 9001:2015 në drejtim të shoqërisë "Kristalina - KH" sh.p.k., është e akredituar nga LATTAQ për të lëshuar disa certifikata në fusha të ndryshme, ku janë të përcaktuara edhe vendet ku lëshohet, nga ku konstatohet se, ky subjekt është i akredituar edhe për ISO 9001:2015 në fushën e veprimtarisë sipas objektit të prokurimit, ndaj dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik "Kristalina – KH" sh.p.k. do të konsiderohet i vlefshëm.

III.2.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, parashikohet se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti*

kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.2.7. Në nenin 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”.*

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.2.8. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. në lidhje me certifikatat ISO 9001 është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Kristalina KH” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se *“[...] makinerite e paraqitura nga shoqeria Kristalina KH shpk nuk jane sipas specifikimeve te kerkuara ne dst dhe nuk kane dokumentacionin e duhur shoqerues pasi mungon dokumentacioni qe verteton disponimin per keto mjete sipas te gjitha percaktimeve te kriterëve ne DST [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në dokumentat e tenderit për Lotin I, Shtojca 9 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, pika 2.3.2 e *“Kapaciteti teknik”*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“2. Operatori ekonomik per te vertetuar qe ka kapacitetet teknike per te ekzekutuar kontraten duhet te disponojë pajisjet e mëposhtme

- Minimumi një makinë shtypi me format min 50 cm X 70 cm;*
- Minimumi një makinë qepëse;*
- Minimumi një makinë telefoni;*

Operatori ekonomik per te vertetuar se i disponon keto tre pajisje duhet te paraqese dokumentacionin ne nje nga format e meposhtme:

- Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose*
- Kontrate huapërdorje, ose*
- Kontrate qiramarrje, ose*
- kontrata e dhurimit;”*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 1110, datë 08.04.2011 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.
- Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 6, datë 08.04.2011 me shitës “Anesti Bega” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.
- Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 1619, datë 12.05.2016 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.
- Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 74, datë 28.02.2008 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.
- Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 17, datë 12.08.2002 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.
- Faturë Tatimore Shitje me Nr serie 60316045, datë 28.06.2018 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.3.4 Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e Mallrave”, pika 5, parashikohet si më poshtë: “5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Sa më sipër, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstaton se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë një makinë shtypi me format min 50 cm X 70 cm ; një makinë qepëse dhe një makinë telefoni, vërtetuar kjo me një nga format e disponimit, duke paraqitur kontratë shitblerje/faturë shitblerje, ose kontratë huajpërdorje, ose kontratë qiramarrje, ose kontratë dhurimi.

Nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar nga operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k., K.P.P konstaton se ky operator ekonomik ka dorëzuar Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 1110, datë 08.04.2011 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.; Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 6, datë 08.04.2011 me shitës “Anesti Bega” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.; Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 1619, datë 12.05.2016 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.; Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 74, datë 28.02.2008 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.; Faturë Tatimore Shitje me Nr fature 17, datë 12.08.2002 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k. për produktin; Faturë Tatimore Shitje me Nr series 60316045, datë 28.06.2018 me shitës “Europrint” sh.p.k. dhe blerës “Kristalina KH” sh.p.k.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, se makineritë e paraqitura nga operatori ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. nuk janë sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentat e tenderit dhe nuk kanë dokumentacionin e duhur shoqërues, pasi mungon dokumentacioni që vërteton disponimin e tyre nga operatori ekonomik “Kristalina KH” sh.p.k., KPP sqaron se, operatori ekonomik ka paraqitur fatura tatimore blerje për makineritë e kërkuara, ku përcaktohet dhe lloji i tyre si në vijim: makinë shtypi 52x74, makinë qepëse dhe makinë telefonimi, duke vërtetuar kështu se ky operator ka kapacitetet e duhura në lidhje me makineritë e kërkuara.

Për më tepër, KPP thekson se, autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, kriteret për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2, ka parashikuar detyrimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi dorëzimin e dokumentacionit të vërtetimit të disponueshmërisë së makinerive me një nga format e parashikuara nga ligji, ku një ndër format e kërkuara nga autoriteti kontraktor është ajo me më anë të faturave të shitblerjes, formë kjo e cila është përdorur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” sh.p.k. për vërtetimin e disponimit të mjeteve të kërkuara. Sa më sipër cituar, rezulton se operatori ekonomik “Kristalina KH” sh.p.k., me anë të dokumentacionit të paraqitur përmbush më së miri kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në përfundim, operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. me dokumentacionin e paraqitur dëshmon se plotëson kapacitetin teknik, në lidhje me disponimin e makinerive të kërkuara nga autoriteti kontraktor për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:

III.4.1. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.*

III.4.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.4.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. nuk qëndrojnë, pasi ky i fundit përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kristalina – KH” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin “[...]KVO ka kualifikuar per Lotin I operatorin ekonomik Inpress shpk. Shoqeria jone, Kristalina KH, e cila operon prej vitesh ne tregun e shtypshkrimeve, nga njohurite qe kemi na rezulton se, ky Operator Ekonomik, qe keni shpallur fitues ka mangesi te medha ne dokumentacionin e paraqitur ne SPE per keto dy procedura, konkretisht si me poshte:

-Operatori ekonomik pjesemarres per Lotin 1, kriteret e vecanta, duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fondit limit te secilit Lot sidomos ne Lotin e 1. Duke qene i shpallur fitues ne te dyja lotet ku operator ekonomik nuk ploteson kriteret e e kualifikimit qe te kete eksperience jo me pak se 40 % per secilin lot vecmas. Duke ditur specifiken

e ketij tenderi dhe duke patur parasysh faktin qe eshte nje tender me rendesi kombetare mendojme se kjo kompani nuk mundet ta realizoje kete tender. Deftesat dhe rregjistrat kerkojne qe te realizohen ne kohe rekord dhe me nje cilesi te larte pasi sic e theksova edhe me lart kane nje rendesi te vecante kombetare. Nje kompani me eksperience te limituar ose pa experience identike e ka te pamundur ta perballoje dhe ta realizoje me sukses dhe si pasoje do kete vonesa ne realizimin e kontrates dhe cilesi te dobet. Per kete gje jemi te bindur pasi kemi eksperience te meparshme me kete tender. Deftesat jane punim me 4C dhe Inpress shpk nuk e ka vertetuar se ka eksperienca te ngjashme ose identike cka e ben te pamundur qe ajo vete ta realizoje nje pune te tille me cilesi dhe korrektesi ne ditet e perfundimit te shkolles gje e cila mund te behet pengese per nxenesit te cilet aplikojne per te studiuar jashte vendit ose per studentet te cilet duan te aplikojne per studime universitare Brenda vendit. Rregjistrat e shkollave dhe Amzat jane punime te vecanta, speciale dhe mjaft specifike te cilat mund te realizohen nga nje kompani me cikël te mbyllur prodhimi, dhe me nje staf mbi 20 persona dhe te gjithë me experience disa vjecare dhe me makineri qe ofrojne rendiment per punimet special. Kompania ne fjale nuk verteton se ka kapacitet te mjaftueshem te asnjë lloji per realizimin e ketyre punimeve dhe me specifikisht te Lotit I i cili ka rendesi kombetare dhe ndjeshmeri kombetare qe lidhet me realizimin ne kohe dhe me cilesi. Ne nuk kemi informacion se cfare profesionesh ka te deklaruar kjo kompani si te punesuar prane saj. Nuk e dime nese ka makiniste (disa) staf liberlidhje (disa), makine per punime speciale rregjistrat, libra etj, makine qepje me pe per qepjen e fashikujve te rregjistrave dhe Amzave. Keto qe po citojme jane te detyrueshme per mendimin tone pasi pervec periudhes 1 nje vjecare te perdorimit te perditeshem te tyre ato gjithashtu ruhen per nje periudhe 10 vjecare cka e ben absolutisht te nevojshme cilesine e tyre dhe eksperiencen ne mos identike te pakten teper te ngjashme [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën nr. 9, për Lotin I pika 2.3.1 “Për Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të Lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.5.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ”Inpress” sh.p.k., ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë Tatimore Shitje nr.12, datë 02.10.2018, me vlerë 14.748.510 lekë pa tvsh, me shitës “Inpress” sh.p.k. dhe blerës “Interlogistic” sh.p.k., për blerjen e mallrave Set shtypshkrimesh

(Blloqe, libreza, libra, procesverbale), shoqëruar me listën e artikujve për të cilën është lëshuar kjo faturë.

- Faturë Tatimore Shitje nr.13, datë 19.11.2018, me vlerë 11.323.900 lekë pa tvsh, me shitës “Inpress” sh.p.k. dhe blerës “Interlogistic” sh.p.k., për blerjen e mallrave Materiale shtypshkrimesh (Blloqe, libreza, libra, procesverbale), shoqëruar me listën e artikujve për të cilën është lëshuar kjo faturë.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.5.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.5.5. Neni 27, pika 4 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”*, i ndryshuar parashikon :

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. »

III.5.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e eksperiencës së ngjashme ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë se kanë kryer furnizime të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të Lotit. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k. për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur Faturë Tatimore Shitje nr.12, datë 02.10.2018, me vlerë 14.748.510 lekë pa tvsh, me

shitës “Inpress” sh.p.k. dhe blerës “Interlogistic” sh.p.k., për blerjen e mallrave Set shtypshkrimesh (Blloqe, libreza, libra, procesverbale), shoqëruar me listën e artikujve për të cilën është lëshuar kjo faturë, si dhe Faturë Tatimore Shitje nr.13, datë 19.11.2018, me vlerë 11.323.900 lekë pa tvsh, me shitës “Inpress” sh.p.k. dhe blerës “Interlogistic” sh.p.k., për blerjen e mallrave Materiale shtypshkrimesh (Blloqe, libreza, libra, procesverbale), shoqëruar me listën e artikujve për të cilën është lëshuar kjo faturë.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentave të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k. në lidhje me eksperiencën e ngjashme, KPP, konstaton se, me dokumentacionin e paraqitur, ky i fundit vërteton se ka kryer furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë më të madhe se 40 % e fondit limit, duke plotësuar kështu kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit për sa i përket eksperiencës së ngjashme. Konkretisht, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k., KPP konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjithë elementëve të faturave të paraqitura dhe dokumentacionit bashkelidhur tyre, vërtetohet se furnizimet e kryera janë të ngjashme me furnizimet që kërkohen nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

III.5.8. KPP gjykon se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi, kërkesë kjo e cila plotësohet më së miri nga ana e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Kristalina KH” sh.p.k. nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Kristalina – KH” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. se *“...Rregjistrat e shkollave dhe Amzat jane punime te vecanta, speciale dhe mjaft specifike te cilat mund te realizohen nga nje kompani me cikël te mbyllur prodhimi, dhe me nje staf mbi 20 persona dhe te gjithë me experience disa vjecare dhe me makineri qe ofrojne rendiment per punimet special. Kompania ne fjale nuk verteton se ka kapacitet te mjaftueshem te asnje lloji per realizimin e ketyre punimeve dhe me specifikisht te Lotit I i cili ka rendesi kombetare dhe ndjeshmeri kombetare qe lidhet me realizimin ne kohe dhe me cilesi. Ne nuk kemi informacion se cfare profesionesh ka te deklaruar kjo kompani si te punesuar prane saj. Nuk e dime nese ka makiniste (disa) staf liberlidhje (disa), makine per punime speciale rregjistra, libra etj, makine qepje me pe per qepjen e fashikujve te rregjistrave dhe Amzave. Keto qe po citojme jane te detyrueshme per mendimin tone pasi pervec periudhes 1 nje vjecare te perdorimit te perditeshem te tyre ato gjithashtu ruhen per nje periudhe 10 vjecare cka e ben absolutisht te nevojshme cilesine e tyre dhe eksperiencen ne mos identike te pakten teper te ngjashme.”*

III.6.1. K.P.P. gjykon se në rast se operatorit ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor në lidhje me kapacitetet e stafit apo mjeteve të

tjera, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-10203-02-22-2019, me objekt Loti I “Blerje dokumentacioni për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, me fond limit 4.853.449 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 761 Protokolli
Datë 26.04.2019

Nr. 767 Protokolli
Datë 26.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha